



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1408

NR. VENDIMI 2059



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. Akti 1408

Nr. 2059 Vendimi

Dt. Regj. 08.07.2015.

Dt. 22.06.2016.

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Sot ne daten **22.06.2016**, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, trupi gjykues i perbere nga :

GJYQTARE - MIGENA LASKA

Asistuar nga sekretare **Fahrie Gjoçaj**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike, ceshtjen penale qe i perket:

E DENTUAR AKUZUES: *****, *** dhe i ***,** i

dtl. *,** lindur dhe banues ne *****,** me arsim te larte, i martuar me 2 femije, i vetepunesuar ne privat, i padenuar me pare, me kombesi dhe shtetesi shqiptare. (Ne Mungese).

I perfaqesuar nga **Av. ***,** me Nr. ***** License dhe Nipti *** Dhoma Av.Tirane,** si dhe nga **av. ***,** me Nr **Lic. *** dhe NIPT-*** Dhoma Av.Tirane.**

Te deklaruar ne seance gjyqesore nga vete i demtuari akuzues.

TE AKUZUAR:
I perfaqesuar nga Av. ***, e
pajisur me Autorizim.

Personi Juridik “Televizioni ***”

I AKUZUAR:
penale te

Per kryerjen e kundravajtjes

i padrejte

“*Riprodhim*

i vepres se tjetrit”,

parashikuar nga neni

149 i K. Penal.

PERSON I INTERESUAR:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane,
perfaqesuar nga

prokurori,

***.

BAZA LIGJORE:
149 te

Nenet 59, 69 te K. Pr. Penale dhe

Kodit Penal.

Gjykata pasi bëri verifikimin e paraqitjes së palëve ne seance, i
dëgjoi ato, të cilat në përfundim kërkuan:

Perfaqesuesi i te demtuarit akuzues, Av. *:**

*“Denimin e fajtorit, Personit juridik “TV ***” me minimumin e
sanksionit te parashikuar nga ligji, sipas nenit 149 te K.Penal ne lidhje
me nenin 11 te ligjit nr.9754, date 14.06.2007 “Per Pergjegjesine
Penale te personave juridike”, si dhe shperblimin e demit”.*

Perfaqesuesi i te akuzuarit, Av. *:**

*“Rrezimin e kerkeses se te demtuarit akuzues ***, si te pabazuar ne ligj
dhe ne prova”.*

Prokurori i ceshtjes z. *:**

*“Pushimin e ceshtjes, duke qene se ceshtja objekt gjykimi nuk perben
kundervajtje penale te parashikuar nga neni 149 i K. Penal”*

Gjykata, pasi shqyrtoi, pretendimet e paleve, te gjitha provat e
administruara ne seance gjyqesore dhe ceshtjen ne teresi;

V Ë R E N :

Gjykata, bazuar ne nenet **69, 74 dhe 76 te K.Pr.Penale**, konstaton se eshte kompetente si ne pikepamjen lendore ashtu dhe ne ate tokesore per te shqyrtuar ceshtjen gjyqesore penale te paraqitur per shqyrtim perpara saj nga e demtuara akuzuese, bazuar ne nenin 59 te Kodit te Procedures Penale, lidhur me akuzen per kryerjen e kundravajtjes penale te parashikuar nga neni 149 i Kodit Penal, *“Riprodhim i padrejte i vepres se tjetrit”*, ne lidhje me personin e akuzuar prej tij: Personi Juridik *“Televizioni ***”*.

• Gjate shqyrtimit gjyqesor, rezultoi se,

Pala e demtuar akuzuese, ne kete gjykim, ka pretenduar si me poshte:

I demtuari akuzues, **Z. *****, eshte autor i vepres: *“Videogram 20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”*, per te cilen, mbeshtetur ne ligjin nr. 9380, date 28.04.2005 *“Per te drejten e autorit dhe te Dretat e tjera te lidhura me te”*, si dhe VKM nr. 232, date 19.04.2006 *“Per krijimin e funksionimin e Zyres Shqiptare per te Drejtat e Autorit”*, te cilen e ka certifikuar me regjistrimin e se drejtes se autorit per vepren ne fushen: *“Krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera Audiovizuale”*, me certifikaten e Rregjistrimit date 31.10.2007.

Gjithmone sipas te demtuarit akuzues, nga ana e personit Juridik *“Televizioni ***”*, ne kundershkrim me ligjin nr. 9380, date 28.04.2005 *“Per te drejten e autorit dhe te Dretat e tjera te lidhura me te”*, si dhe VKM nr.232, date 19.04.2006 *“Per krijimin e funksionimin e Zyres Shqiptare per te Drejtat e Autorit”*, pikerisht me dt. *******, ne edicionin e lajmeve eshte transmetuar pa lejen perkatese te autorit, vepra:

“Videogram 20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”.

Pikerisht bazuar ne sa me siper, i demtuari akuzues, ka paraqitur kete kerkese per gjykim, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, duke i kerkuar gjykates, deklarimin fajtor per personin Juridik *“Televizioni ***”*, dhe denimin penal perkates, ndaj tij, per kryerjen e kundravajtjes penale te *“Riprodhim i padrejte i vepres se tjetrit”*, parashikuar nga neni 149 i K. Penal.

- Per te provuar kete pretendim jane paraqitur provat si me poshte:

- *Shkresa e ZSHDA me titull “Certifikate Rregjistrimi”, date 31.10.2007;*

- DVD e shoqeruar nga nje shkrese percjellese e Autoritetit te Mediave Audiovizive, qe permban transetimet e lajmeve TV *** ne daten 20.02.2015;
- Shkresa te drejtuara TV *** nga av. ***, ne cilesine e perfaqesuesit te z. ***.
- Kontrata mes *** dhe ***.
- Vendimi nr. ***, date 03.07.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Shpjegim perfundimtar te Zyres Shqiptare.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, bazuar ne provat e sjella ne gjykim nga pala e demtuar akuzuese, ka rezultuar se, pretendimet e saj jane te pabazuara ne ligj dhe ne prova.

Gjykata ka arritur ne kete konkluzion, bazuar ne gjithe arsyetimin e meposhtem:

• BAZA LIGJORE E ZBATUAR:

Neni 149

Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit

Riprodhimi tërësisht ose pjesërisht i veprës letrare, muzikore, artistike ose shkencore që i përket një tjetri, ose përdorimi i tyre pa pëlqim të autorit, kur kanë shkelur të drejtat vetjake e pasurore të tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

*Per te analizuar elementetet e figures se kesaj kundravajtje penale, meqenese nga menyra e formulimit te dispozites nuk percaktohet se cfare kuptohet me **vepra, me riprodhim, me te drejte autori dhe me te drejta vetjake pasurore** dhe kur keto te drejta shkelen, Gjykata I eshte referuar legjislacionit perkates shqiptar, i cili rregullon marredheniet ne kete fushe, konkretisht ligji:*

a) Nr. 9380, date 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te Dretat e

tjera te lidhura me te”,

- b) Konventave, te kesaj fushe ne te cilat ka aderuar Republika e Shqiperise,
- c) si dhe ***Ligjit nr. 97/2013 “Per Mediat Audiovizive ne Republiken e Shqiperise”.***

Objekti I kundravajtjes penale:

Vepra: “Videogram 20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes” , perben nje xhirim me kamera te momentit te renies se bustit te Enver Hoxhes, te kryer nga z. *** ne kushtet kur ai ka qene i punesuar prane Radio Televizionit Shqiptar.

Ky filmim, eshte transmetuar per se pari here, nga Televizioni Publik Shqiptar, pjese e kronikave te lajmeve te kohes.

Pretendimi i te demtuarit akuzues, eshte se kjo videogramme eshte transmetuar ne edicionin e TV ***, dhe referuar ligjit per te drejten e autorit, ky veprim eshte i ndaluar te kryhet pa lejen e autorit te vepres.

Ne nenin 9 “***Rastet e Perjashtimit***”, pika “d” te ligjit nr. 9380, date 28.04.2005 “*Per te drejten e autorit dhe te Dretat e tjera te lidhura me te*”, percaktohet se: “***Nuk jane objekt i te drejtes se autorit dhe nuk gezojne mbrojtje nga ky ligj lajmet dhe informacionet e shtypit***”.

Keshtu, meqenese objekti i vepres penale per te cilen akuzohet pala e akuzuar eshte paprekshmeria e se drejtes se autorit, rezulton qe kjo e drejte nuk eshte prekur apo cenuar duke bere qe ne rastin konkret te jete in-ekzistent objekti i vepres qe i atribuohet te akuzuarit, si nje nder elementet kryesore te vepres penale.

Ana objektive e kundravajtjes penale:

Nga ana objektive, ***neni 149 i K. Penal*** merr ne mbrojtje nje kategori te caktuar te veprave te autorit, qe jane veprat: letrare, muzikore, artistike ose shkencore.

Ne nenin 4, pika 1 te ligjit nr. 9380, date 28.04.2005 “Per te drejten e autorit dhe te Dretat e tjera te lidhura me te”, percaktohet se:

“...Veper artistike eshte cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik i materializuar, pavaresisht nga forma a menyra e te shprehurit, qe ka per qellim te preke ndjesite e njeriut”.

Pra, veper artistike do te quhet cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik, ndersa videogrami objekt i ketij gjykimi, nuk eshte veper artistike, pasi ai nuk perben nje krijim origjinal dhe intelektual, pasi ai paraqet thjesht filmimin e nje ngjarje per t’u transmetuar (*ne rastin konkret*) ne nje edicion informativ lajmesh, filmim qe mund te jete kryer edhe nga subjekte te tjere.

Ne vazhdim, menytrat e kryerjes se vepres penale jepen ne dispozite, si ***riprodhimi*** ose ***perdorimi pa te drejte*** teresisht ose pjeserisht i vepres se tjetrit ose perdorimi pa pelqimin e autorit.

I demtuari akuzues dhe mbrojtja e tij, gjate gjithë ketij shqyrtimi gjyqesor, nuk kane arritur qe te provojne, te dokumentojne, te sqarojne perpara gjykates dhe paleve ndergjyqese, se ne cilat pjese te DVD-se, (marre nga AMA dhe te paraqitur me cilesine e proves ne kete gjykim), e shfaqur ne lajmet e dates 20.02.2015 ne TV ***, eshte transmetuar video-grama e regjistruar ne autoresine e pretenduar nga i demtuari akuzues?!.....

Apo qofte edhe te jete provuar fakti se, pikerisht pjeset e regjistruara prej tij, kane qene objekt konkret i transmetimeve te kryera nga pala e akuzuar “Televizioni ***” ne edicionin informativ te lajmeve te dates 20.02.2015.

Keshtu, ne kerkesen e paraqitur dhe ne parashtrimet e te demtuarit akuzues, ngrihet pretendimi se videograma eshte perdorur ne edicionin e lajmeve te dates 20.02.2015. Por nuk eshte argumentuar dhe provuar konkretisht se, ne cilen pjese jane perdorur pamjet e regjistruara nga Z. ***, nese eshte perdorur i tere regjistrimi i kryer prej tij apo pjeserisht.

“***Certifikata e Rregjitrimit***”, eshte prova e vetme, bazuar ne te cilen i demtuari akuzues ka pretenduar perpara kesaj Gjykate, se vepra nen autoresine e tij eshte shfaqur ne transmetimet e TV ***.

Nje kusht tjetër i domosdoshëm *i anës objektive, është që të jenë shkelur te drejtat pasurore te autorit.*

Nese i referohemi Ligjit për të drejtën e autorit, neni 74 përcakton: “Shperblimet për çdo mënyrë shfrytëzimi të veprës kinematografike dhe / ose audiovizuale llogaritet në mënyrë proporcionale me të ardhurat e përgjithshme, që rrjedhin prej tij.”

Bazuar në këto dispozite ligjore, edhe nëse vepra do të ishte përdorur nga i akuzuari, në asnjë moment nuk do të ishin cenuar të drejtat pasurore të autorit, pasi edicionet e lajmeve kanë vetëm qëllime informative dhe nuk sjellin përfitim ekonomik.

Nisur nga sa më sipër, rezulton të jenë konsumuar të katër elementet baze dhe të domosdoshëm për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 149 i K. Penal.

Ligji nr. 9380/2005 “*Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të etj*”, garanton mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që marrin pjesë në veprimtari krijuese, prodhuese, tregtare ose çdo veprimtari tjetër vlerësimi, shfrytëzimi, përdorimi a tjetërsimi të veprave letrare, shkencore apo artistike, (nenet 1 dhe 2 të Ligjit).

Subjekt i së drejtës së autorit, është personi që krijon një vepër letrare, shkencore apo artistike, (neni 5).

Ndërsa *objekt i të drejtës së autorit* është produkti/vepra e punës krijuese të mendjes së njeriut, ku përfshihet midis të tjerave edhe krijimet vizuale, (neni 7/d).

Vepër konsiderohet edhe një produkt i cili krijohet nga kompozimi i disa veprave, (vepër e prejardhur), (neni 8).

Në nenin 9/dh të Ligjit nr. 9380/2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të etj”, parashikohet midis të tjerave se nuk janë objekt i të drejtës së autorit dhe nuk gëzojnë mbrojtje, lajmet dhe informacioni i shtypit.

Në këtë Ligj, përcaktohen të drejtat vetjake jopasurore dhe ato pasurore të autorëve të veprave, mjetet e mbrojtjes së këtyre të drejtave, organet kompetente që garantojnë mbrojtjen dhe rivendosjen e tyre, procedurat përkatëse për ankimet administrative si dhe të drejtën e subjekteve për t’iu

drejtuar gjykatës duke kërkuar shpërblimin përkatës dhe ndalimin e cënimit të së drejtave.

Në nenin 28 të Ligjit nr. 9380/2005 “***Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të etj***”, parashikohet shprehimisht rastet kur riprodhimi i veprës së autorit pa qëllime fitimi, mund të kryhet pa leje apo autorizim të tij.

Në këtë dispozitë shprehimisht thuhet:

“1. Riprodhimi i veprës ose i një pjese të saj mund të bëhet pa autorizimin e autorit a të titullarit të të drejtës së autorit, në rastin e dhënies në huapërdorje të veprave nga institucionet publike, që disponojnë kopje origjinale të ligjshme të veprës, vetëm për reklamë kulturore, por pa qëllim fitimi.

2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni bëjnë:

a) partiturat muzikore dhe operistike;

b) fonogramet dhe videogramet, që përmbajnë vepra muzikore, kinematografike ose audiovizuale, sekuenca filmike, me ose pa zë, me kusht që të kenë kaluar 18 muaj nga ushtrimi i të drejtës së shpërndarjes për herë të parë.

3. Si huapërdorje, në këtë rast, nënkuptohen:

a) fotokopje të veprës origjinale, me përjashtim të partiturave operistike dhe muzikore;

b) fonograme dhe videograme që përmbajnë vepra muzikore, kinematografike, audiovizuale ose sekuenca të pamjeve filmike, me ose pa zë, me kusht që të kenë kaluar 18 muaj nga ushtrimi i të drejtës së shpërndarjes për herë të parë.”

Neni 149 i K.Penal, parashikon se :

“Riprodhimi teresisht ose pjeserisht i vepres letrare, muzikore, artistike ose shkencore qe i perket nje tjetri ose perdorimi i tyre pa pelqimin e autorit, kur kane shkelur te drejtat vetjake e pasurore te tij, perben kundravajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dy vjet”.

Ky nen mbron marredheniet juridike te vendosura per te mbrojtur paprekshmerine e te drejtes se autorit nga veprimet ose mos veprimet kriminale.

Nga ana objektive, vepra penale kryhet me ane te riprodhimit, te vepres qe do te thote ribotim me cdo lloj mjeti, fotokopjim riprodhim me dore etj, te vepres letrare, muzikore, arstistike ose shkencore.

Gjykata veren, se, neni 149 i K. Penal merr ne mbrojtje nje kategori te

caktuar te veprave te autorit, qe jane veprat *letrare, muzikore, artistike ose shkencore*.

Ne nenin 4, te Ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 “*Per te drejten e autorit dhe te drejatat e tjera te lidhura me te*”, jepen perkufizime te vepres artistike, vepres letrare, vepres muzikore, vepres arkitekturore, vepres teatrore, vepres dramatike, vizatim, gravure, videogramit, skulptures, etj.

Videogrami, objekt i ketij gjykimi, nuk eshte as veper letrare, as muzikore dhe as shkencore.

Kategoria tjeter qe merret ne mbrojtje nga neni 149 i K. Penal ka te beje me riprodhimin teresisht ose pjeserisht te vepres artistike.

Ne nenin 4, pika 33, te Ligjit nr. 9380, dt.28.04.2005 “*Per te drejten e autorit dhe te drejatat e tjera te lidhura me te*”, percaktohet se:

“...Veper artistike eshte cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik i materializuar, pavaresisht nga forma a menyra e te shprehurit, qe ka per qellim te preke ndjesite e njeriut”.

Pra, veper artistike do te quhet cdo krijim origjinal, intelektual i nje personi fizik, ndersa “Videogrami “20 shkurti, renia e bustit te Enver Hoxhes”, objekt i ketij gjykimi eshte videogram, filmim i nje momenti historik dhe jo krijim origjinal i te demtuarit akuzues ***.

Gjykata cmon se transmetimi i ketij videogrami nga ana e “Televizionit ***”, ne edicionin informativ te lajmeve, edhe nese do te rezultonte i provuar fakti qe, videogrami I regjistruar nga I demtuari akuzues ***, si tere ose pjeserisht, do te perkonte ose thene me sakte do te ishte pikerisht ai i transmetuar ne lajmet e TV ***, ne cdo rast nuk do te ndodheshim perpara konsumimit te kundravajtjes penale te parashikuar nga neni 149 te K. Penal, per sa kohe qe kjo dispozite material penale nuk perfshin ne objektin e saj videogramin, si pjese e kategorise se veprave te autoreve te mbrojtura nga ligji penal.

Pra ligjvenesit, ka percaktuar vetem kater kategori veprash te autoreve qe merren ne mbrojtje nga ligji penal (*vepra letrare, muzikore, artistike ose*

shkencore) dhe videogrami nuk ben pjese ne keto vepra.

Neni 388

Vendimi i pafajësisë

1. Gjykata merr vendim pafajësie kur:

- a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston;
- b) fakti nuk përbën vepër penale;**
- c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
- ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet;
- d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet;
- e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qënien e tyre.

Ne keto kushte dhe per keto arsye, bazuar ne gjithe sa me siper, Gjykata krijon bindjen e saj te thelle, te mbeshtetur ne prova dhe ne ligj, si dhe **bazuar ne nenin 388/b te K.Pr.Penale**, se fakti (*transmetimi i videogrames*) nuk perben veper penale, ndaj ne keto kushte personi juridik I akuzuar duhet te deklarohet i pafajshem.

PER KETO ARSYE:

Gjykata, bazuar ne neni 149 i K. Penal, si dhe ne nenet 59, 60, 388/b te K.Pr.Penale,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e pafajshem te te akuzuarit **Personit Juridik “TV ***”**, per kryerjen e kundravajtjes penale te **”Riprodhimi pa te drejte i vepres se tjetrit”** te parashikuar nga neni 149 i K. Penal.
2. Shpenzimet gjyqesore, vihen ne ngarkim te pales se demtuar akuzuese.
3. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 10 diteve, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes ose e komunikimit te ketij vendimi.
- 4. U shpall sot ne Tirane, ne daten 22.06.2016.**

SEKRETARE

GJYQTARE
FAHRIE GJOCAJ
MIGENA LASKA